



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 637/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: - Gjakovë kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku i rekomanduar për dhënie të kontratës është OE “D&T Group shpk & HORN & CO. KOSOVA SHPK & NP INOVA SHPK” - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Rregullimi i parkut të qytetit-Kontratë tri vjeçare” me numër të prokurimit :632-18-052-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Gjakovë”, më datën 22.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Marisa shpk” & Gërlica shpk”-Gjakovë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i parkut të qytetit-Kontratë tri vjeçare” me numër të prokurimit :632-18-052-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK - “KK-Gjakovë”,

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i AK -së “KK-Gjakovë”, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Rregullimi i parkut të qytetit-Kontratë tri vjeçare” me numër të prokurimit :632-18-052-521, dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Marisa shpk” & Gërlica shpk”-Gjakovë aprovet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 25.06.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 17.07.2018

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesit e eliminuar. 25.10.2018

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik: “Marisa shpk” & Gërlica shpk”-Gjakovë me dt: 10.08.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 31.10.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “Marisa shpk” & Gërlica shpk”-Gjakovë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: “Marisa shpk” & Gërlica shpk” - Gjakovë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 29.10.2018 me nr. 637/18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi i parkut te qytetit-Kontratë tri vjeçare” me numër të prokurimit :632-18-052-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Gjakovë”, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,7,59,60,72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.11.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 16.11.2018, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues: “Marisa shpk” & Gërlica shpk” - Gjakovë në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të

prokurimit, konstaton si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i ka pretendimet e njëjta ankimore me atë të parashtruar në herën e parë në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Eksperti shqyrtues sqaron se pas vendimit me nr. 450/18 të datës 17.10.2018, AK-Komuna e Gjakovës ka kthyer në rivlerësim këtë aktivitet të prokurimit duke formuar komision të ri. Komisioni i ri vlerësimi ka rekomanduar për dhënie të kontratës të njëjtin operator ekonomik Grup i OE “D&T GROUP SHPK” & “HORN & CO. KOSOVA SHPK” & “NP INOVA SHPK”.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-së nuk i ka marr parasysh sqarimet e dhëna në Vendimin me nr. 450/18 të Panelit Shqyrtues, duke e rekomanduar për kontratë të njëjtin operator ekonomik duke mos vlerësuar siç duhet ofertat konform Nenit 59 të LPP-së sipas këtij Vendimi. Po ashtu, Eksperti sqaron se me datë 23.10.2018, AK-ja ka kërkuar vazhdimin e validitetit të ofertave dhe vazhdimin e sigurimit të tenderit dhe nga gjithsej shtatë (7) OE, katër (4) OE kanë vazhduar validitetin dhe tre (3) OE kanë bërë vazhdimin e sigurimit të tenderit. Eksperti sqaron se të gjitha pikat tjera të raportit të ri vlerësimi janë të njëjta me raportin e vlerësimi dhe se nuk ka dëshmi që neni 59 i LPP-së është zbatuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues “MARISA SHPK & GËRLICA SHPK”, Eksperti shqyrtues, sqaron se pretendimet e parashtruara në ankesë janë të njëjta me pretendimet ankimore të parashtruara në rastin e mëparshëm, për të cilat Eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigje në raportin e datës 17.09.2018. Prandaj, në bazë të kësaj Eksperti sqaron se ankesa e OE ankues është e përsëritur dhe se pretendimet ankimore konform rregullores së punës së OSHP-se, konkretisht nenit 16.2 të trajtohen si “Res Judicata”.

Në fund eksperti shqyrtues, sqaron se AK- Komuna e Gjakovës, nuk e ka respektuar vendimin e Panelit Shqyrtues me nr. 450/18, të datës 17.10.2018, prandaj ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet e sipër përmendur anr. 1 dhe 2) dhe të anulohet Vendimi i AK për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues – “KK-Gjakovë”, me datë: 19.11.2018, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se me disa pika nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: “Marisa shpk” & Gërlica shpk” - Gjakovë, me datë: 20.11.2018, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se a pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertës shqyrtuese profesional, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi konstaton se autoriteti kontraktues gjatë rekomandimit për dhënie të kontratës së OE “D&T Group shpk & HORN & CO KOSOVA SHPK & NP INOVA SHPK”, NUK ju ka përmbajtur Vendimit PSH. nr. 450/18.

Paneli shqyrtues konstaton se duke pas parasysh faktin se anëtari i konsorciumit “INOVA” SHPK me datë:16.11.2018, përmes shkresës ju ka drejtuar Organit Shqyrtues të prokurimit dhe zyrës së Prokurimit në KK Gjakovë, ku kërkon **Citat:** Ne kompania jonë “INOVA” SHPK me nr. Biznesi 70086064, në lidhje me projektin me titull: “*Rregullimi i Parkut të Qytetit-Kontratë tre Vjeçare*”, ju njoftojmë se kemi marr vendim që të tërhiqemi nga gara në këtë projekt, konkretisht nga grupi i OE “D&T Group shpk & HORN & CO KOSOVA SHPK & NP INOVA SHPK”, arsyeja e tërheqjes nga gara për këtë tender është vonesa në fillin e punëve për shkak të procedurës tenderuese, ku ne si kompani kemi kontraktuar punë të tjera, dhe nuk mund të angazhohemi dhe të marrim asnjë përgjegjësi në lidhje me këtë projekt.

Gjithashtu me rastin e rivlerësimit AK-ja, duhet të veproj në pajtim me nenin 59 të LPP-së duke e bërë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave në pajtim me këtë nenë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –KK-Gjakove
- 1x1 OE- “Marisa shpk” & Gërlica shpk”-Gjakovë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković